



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 09 – 23 korrik 2018.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”. *(Komision për dhënie mendimi)*
4. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”. *(Komision për dhënie mendimi)*
5. Projektligj “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”. *(Komision për dhënie mendimi)*
6. Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu.

Të Ftuar:

Gazmend Barbullushi - Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Bako (Kuci) - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Dorina Çinari – Zëvendësministre e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Ilir Bejtja – Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Stavri Dhima – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Anisa Pine - Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Aldo Xherahu – Fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë
Bardhylka Kospiri - Zëvendësministre e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Sociale

Denada Seferi - Drejtore e programeve të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mejvis Kola –

Tedi Bushaj - Drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi - Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit:

Benet Beci - Drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Ermir Omari -

Robert Gajda - Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimoza Dhëmbi – Drejtore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Vilma Çausholli - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes është i pranishëm, kështu që vazhdojmë me rendin e ditës. Kemi gjashtë çështje për të diskutuar.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 09 – 23 korrik 2018. Jeni dakord me kalendarin? Ka sugjerime për kalendarin? Nuk ka. Miratohet kalendari i punimeve të komisionit për periudhën 09 - 23 korrik 2018.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator i këtij projektligji është kolegu Çuçi. Ka konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme zoti Gazmend Barbullushi, sekretar i Përgjithshëm.

Zoti Barbullushi, ju lutem bëni shkurtimisht një prezantim të kësaj marrëveshjeje. Më pas fjalën do ta marrë relatori, kolegu Çuçi.

Gazmend Barbullushi – I nderuar zoti kryetar!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë!

Në cilësinë e përfaqësuesve të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, jam këtu bashkë me dy drejtorë: zonjën Elida Petoshati, drejtore për Rajonin dhe zotin Armand Skapi, drejtor për Traktatet, për të paraqitur për praninë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.

Marrëveshja ka si qëllim përcaktimin e rregullave të funksionimit të kësaj organizate ndërkombëtare, që vendoset në vendin tonë, statusin ligjor, si dhe privilegjet dhe imunitetet e personelit të saj.

Me krijimin e një fondi të përbashkët, të arritur tashmë me marrëveshjen për themelimin e tij në Pragë në vitin 2015, synohet, së pari, realizimi i financimit të projekteve të vogla dhe të mesme në fusha të ndryshme dhe së dyti, afrimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe forcimi në parim i bashkëpunimit rajonal. Marrëveshja me vendin pritës ndihmon dhe mundëson zbatimin dhe implementimin e marrëveshjes për themelimin e vetë fondit.

Duhet thënë se pranimi nga vendet anëtare të këtij organizmi për vendosjen e selisë së fondit në Tiranë dhe zgjedhjen e drejtorit të parë ekzekutiv nga Shqipëria është rezultat që tregon kontributin dhe rolin konstruktiv që ka luajtur dhe luan Shqipëria në rajon, kurorëzon

përpyjekjet tona dhe përbën një sukses të politikës sonë të jashtme. Deri më sot, asnjë nismë rajonale nuk ka pasur selinë e saj në Shqipëri.

Për sa i takon ligjshmërisë dhe përmbajtjes së marrëveshjes, projektligji është në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës, me vetë marrëveshjen për themelimin e fondit, të nënshkruar në Pragë në vitin 2015, ka hyrë në fuqi në vitin 2017 dhe është në përputhje edhe me ligjin nr. 43 “Për marrëveshjet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 156 të këtij viti dhe është nënshkruar në muajin prill të këtij viti. Është e bazuar në statutin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, e cila vet është pjesë e marrëveshjes për themelimin. Është strukturuar në dy pjesë: në pjesën hyrëse me preambulën dhe 24 nene. Nga neni 2 deri në nenin 10 sanksionon privilegjet dhe imunitetet ...

Ulsi Manja – Nuk është e nevojshme, sepse kolegët e kanë mbi tryezë.

Gazmend Barbullushi – Institucioni që ngarkohet për zbatimin e kësaj marrëveshjeje është Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme. Për sa u takon shpenzimeve financiare, që do të ishte një pikë e rëndësishme, marrëveshja nuk sjell efekte direkte financiare nga pikëpamja buxhetore. Ambienti ku ka selinë sekretariati i fondit është ofruar pa pagesë për një periudhë 5-vjeçare.

Ju falenderoj për vëmendjen!

Jemi të gatshëm t’ju japim çdo informacion dhe t’i përgjigjemi çdo pyetjeje.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Barbullushi!

Fjalën e ka relatori, kolegu Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Siç e tha edhe sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, në datën 13 nëntor të vitit 2015 në Pragë është nënshkruar marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Sot, Kuvendi kërkon që ta ratifikojë këtë fond, anëtarët e të cilit janë Shqipëria, Bosnjë – Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Serbia. I rëndësishëm për Shqipërinë është fakti që si vend pritës, selia e punës do të vendoset në Tiranë.

Kështu që, në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të drejtat e Njeriut, pasi vlerëson se në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren në fuqi, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim dhe pasi ta shqyrtojmë nen për nen dhe në tërësi, duhet ta miratojë atë me shumicën e anëtarëve të tij dhe të vendosë për kalimin në seancë plenare.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çuçi!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.

Vazhdojmë me votimin nën për nën të këtij projektligji.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09. 07. 2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TransAdriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu.

Të Ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lera - Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Enkeleda Bako (Kuci) - Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Dorina Çinari – Zëvendësministre e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilir Bejtja – Këshilltar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Stavri Dhima – Përgjegjës Sektori në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Anisa Pine - Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Aldo Xherahu – Fotograf në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TransAdriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator do të jetë kolegu Bashkim Fino.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë zoti Erion Luçi, zëvendësministër, zoti Nikolla Lera, drejtor, zonja Enkeleda Bako, përgjegjëse sektori, kurse nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zonja Dorina Çinari, zëvendësministre, zoti Ilir Bejtja, këshilltar, zoti Enea Karakaçi, drejtor, zoti Stavri Dhima, përgjegjës sektori, zonja Anisa Pine, specialiste dhe zoti Aldo Xherahu, fotograf. Paska ardhur i gjithë personeli i të dy ministrive. Siç duket, sot nuk keni pasur me çfarë të merreshit atje dhe keni ardhur të gjithë në komision.

Kush e do fjalën nga ministria e Financave dhe Ekonomisë? Ju lutem prezantohuni.

Enkeleda Kuçi – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, zoti Lera ka ardhur, por është në sallë.

Përsëritet! Unë jam Enkeleda Kuçi, përgjegjëse në sektorin e analizave dhe politikave për çështjet fiskale.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, së bashku me Ministrinë e Energjisë kanë bashkëpropozuar projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TransAdriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”. Në fakt, është një marrëveshje e ratifikuar me ligjin nr. 116\2013. Sot po propozojmë ndryshimin e dispozitave, që lidhen me trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve për investitorin e projektit.

Qëllimi i këtij projektligji është që të përfshijë në marrëveshjen e ndryshimit me qeverinë e vendit pritës dispozitat që rregullojnë specifikisht trajtimin e tatimit mbi vlerën e shtuar në lidhje me aktivitetet e ndërtimit gjatë fazës së ndërtimit të projektit të gazsjellësit TAP, kryesisht për të përfshirë zbatimin e skemës së autofaturimit në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar për investitorin e projektit dhe kontraktorëve për sa i përket furnizimit të mallrave dhe shërbimeve.

Aktualisht, për gazsjellësin TAP zbatohet skema e tatimit mbi vlerën e shtuar si për të gjitha subjektet e tjera. Pra, është furnizuesi i mallrave dhe shërbimeve ai që detyrohet të

paguajë tatimin mbi vlerën e shtuar, ndërkohë që sot propozohet aplikimi i skemës së autofaturimit duke e emetuar tatimin që duhet paguar me tatimin për të rimbursuar.

Kjo skemë, në fakt, është e njohur edhe nga direktiva e Bashkimit Europian 2006\112 dhe ndërkohë është një skemë që aplikohet tashmë nga shoqëria “Devoll Hydropower”. Pra, është e njëjta skemë që po aplikohet nga shoqëria “Devoll Hydropower”, e cila është ratifikuar me ligjin nr. 105\2013.

Pra, propozojmë të njëjtën skemë edhe për gazsjellësin TAP, për të shmangur sa më shumë vonesat në rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, kolegu Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Diskutimi që shterues. Unë e mirëkuptoj projektligjin për rishikimin e skemës së TVSH-së. Propozimi synon të ulë parametrat e menaxhimit të shumës së kërkesave për rimbursimin e TVSH-së, që do të thotë t’i nënshtrohen TVSH-së nëpërmjet sistemit të autofaturimit.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën, legjislationin në fuqi, kurse në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit. Kështu që, nuk ngelet gjë tjetër veçse ta votojmë në unanimitet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – *(flet pa mikrofon)*

Enkelelda Kuçi – Është çështje procedure, ... që në momentin e parë që do të bëhet korrigjimi... nuk do të ketë më TVSH as për t’u paguar as për t’u rimbursuar.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Bashkim Fino – Kjo tregon që kolegu ynë Pëllumbi nuk do ta bëjë këtë pyetje në komisionin përgjegjës, atë të Ekonomisë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kam pyetje të tjera? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TransAdriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Miratohet në parim.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 2.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Në tërësi.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së ndryshimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave dhe TransAdriatic Pipeline AG, lidhur me marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës”, e cila do t’i kalojë së bashku me raportin përkatës seancës plenare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”. *(komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Bardhylka Kospiri – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Denada Seferi – Drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Mejvis Kola – Përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Tedi Bushaj – Drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Majlinda Hafizi – Drejtoreshë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Anduena Hoxha – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim e Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Komisioni ynë lidhur me këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zonja Bardhylka Kospiri, zëvendësministre, zonja Denada Seferi, drejtoreshë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zonja Mejvis Kola, ndërsa nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë kemi prezentë zotin Tedi Bushaj, drejtor i Borxhit Publik, zonjën Majlinda Hafizi, drejtoreshë, si dhe zonjën Anduena Hoxha, përgjegjëse Sektori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt, unë e lexova te projektligji që sapo kaluam, por, gjithsesi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni i mirëpritur, zoti Luçi!

Vazhdojmë me prezantimin e projektligjit.

Zonja Kospiri, do t’ju lutesha të bënit një prezantim shumë të shkurtër të këtij projektligji për kolegët e mi deputetë.

Bardhylka Kospiri – Faleminderit, zoti kryetar, por a mund të bëj vetëm një sugjerim?

Ulsi Manja – Po.

Bardhylka Kospiri – Të fillojë zoti Luçi, meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë është huamarrëse dhe propozuese, pastaj mua më keni këtu për çdo pyetje.

Ulsi Manja – Biem dakord.

Po ia japim fjalën fillimisht zëvendësministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Ju lutem, zoti Luçi, na bëni një prezantim shumë shkurt për kolegët.

Erjon Luçi – Ky është një projektligj që do të finalizojë një projekt, që ka ardhur edhe më parë në parlament dhe ka avancuar mirë, pavarësisht pjesës së rezultateve që duhet thënë se kanë qenë pozitive për sa i përket ndihmës ekonomike sociale për ristrukturimin dhe për përmirësimin e targetimit të ndihmës ekonomike, por në veçanti edhe për përmirësimin e skemës së individëve në nevojë.

Shumica e komponentëve që kërkuar njëfarë kohe më shumë dhe një financim më të lartë, kanë të bëjnë me komponentin e dytë të pjesës së individëve në nevojë dhe finalizimin

për shtrirjen e skemës së re të ndihmës ekonomike në të gjithë vendin. Bëhet fjalë për rreth 11 milionë dollarë dhe deri në fund të vitit 2021, si kohë.

Termat e kredisë janë terma standardë, por nuk besoj se ka nevojë të hyj në shumë detaje nëse nuk ka ndonjë pyetje. Le të themi se diskutohet finalizimi dhe forcimi i një reforme që ka nisur prej kohësh dhe që deri tani ka dhënë rezultate relativisht pozitive për sa i përket përmirësimit të targetimit dhe trajtimit të individëve në nevojë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luçi!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale bien dakord me...?

Bardhylka Kospiri – Shprehemi dakord, por nëse mund të plotësoj diçka...

Ulsi Manja – Po, urdhëroni!

Bardhylka Kospiri – Dua vetëm të sqaroj disa gjëra për informacion.

Ulsi Manja – Dakord, por, ju lutem, shumë shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bardhylka Kospiri – Nuk ka nevojë? Dakord.

Ulsi Manja – Relatori bie dakord?

Edmond Leka – Shprehem dakord, zoti kryetar, qoftë për sa i përket aspektit ligjor, edhe atij procedural, pasi projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E hedhim në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shitesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim marrëveshja.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është pro në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e modernizimit të asistencës sociale”.

Relatori dhe këshilltarët të bëjnë gati raportin lidhur me këtë projektligj për t’ia kaluar më pas seancës plenare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konjektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”. *(komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – Drejtor i Borxhit Publik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Benet Beci – Drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit

Ermir Omari – Drejtor i projektit

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e konjektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Edhe për këtë projektligj ne jemi komision për dhënie mendimi.

Edhe për këtë marrëveshje relator është kolegu Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: zoti Erjon Luçi, zëvendësministër, dhe zoti Tedi Bushaj, drejtor i Borxhit Publik, ndërsa nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit kemi zotin Benet Beci, drejtor i Fondit, dhe zotin Ermir Omari, drejtor i projektit.

Zoti Luçi, cili prej jush do ta marrë fjalën për prezantimin e kësaj marrëveshjeje?

Erjon Luçi – Po e prezantoj unë.

Kjo marrëveshje është sjellë me kërkesën e qeverisë shqiptare prej gati një viti te Banka Botërore për të përmirësuar dhe optimizuar rrjetin e rrugëve kombëtare. Domethënë, po ta shikoni, rrjeti i rrugëve kombëtare është zgjeruar shumë, sidomos edhe Veriu, por, megjithatë, për shembull, sidomos rrugët lidhëse, për ta shfrytëzuar plotësisht këtë rrjet kombëtar, kanë mbetur pak më mbrapa në aspektin e përdorimit të mirë të këtyre rrugëve.

Ky projekt ndërtohet mbi një projekt po aq të suksesshëm të Bankës Botërore për rrugët rurale, që ka qenë para dy-tre vjetëve, ku pati një përmirësim të ndjeshëm të lidhjes së qendrave të ndryshme të banimit me qendrat tregtare dhe qendrat më të urbanizuara. Përveç kësaj, ky projekt synon edhe lidhjen më të mirë të këtyre projekteve me pjesën tjetër të aktiviteteve të zonave rurale apo turistike, që ju e keni dëgjuar, programi “100 fshatrat” dhe bëhet në koordinim me atë si projekt.

Një tjetër komponent i thjeshtë, për ta theksuar, përpara se ta kaloj për diskutim, është pjesa e përmirësimit të kapaciteteve dhe jo thjesht e investimeve. Ka edhe disa *soft measures* që do të përmirësojnë si kapacitetet e bashkive, ashtu edhe të FSHZH-së, që janë prezente edhe këtu nëse ka ndonjë pyetje për ndonjë detaj të projektit.

Bashkim Fino – Sa është shuma?

Erjon Luçi – Shuma është 50 milionë.

Bashkim Fino – Si ndahet kjo shumë? Na thuaj përtej financës, na thuaj qëllimin.

Erjon Luçi – Për ndarjen po bëhen studimet e fizibilitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Benet Beci – Është në proces. Janë pyetur të 61 bashkitë, kanë sjellë gati 110 propozime. Mbi bazën e kriterëve, që tha zëvendësministri, të turizmit, të bujqësisë, të zhvillimit ekonomik do të bëhet përzgjedhja e projekteve që do të kalohen. Pra, është në proces.

45 milionë e ca janë për investimet, ndërsa pjesa tjetër mbulon supervizionin dhe projektimin, si dhe kostot operacionale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luçi!

Faleminderit, zoti Beci!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Sa rrugë ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të na thoni ndonjë gjë më konkrete?

Erjon Luçi – Konkretisht janë 85 kilometra.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Mirë, e ndërpresim në mbledhjen. Le të presin ata.

Ulsi Manja – Po, absolutisht, jam dakord.

Bashkim Fino – Ne jemi në mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një pyetje. Unë dua të di, 45 milionë janë investime, ndërsa 5 milionë janë shpenzime të tjera, supervizion dhe pagat e tyre.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua të di si është e ndarë shuma 45 milionë në këto 110 propozime. Të 110 propozimet do ta marrin, apo jo? Sepse vërtet edhe ne, edhe Komisioni i Ekonomisë kalon termat e kësaj kredie me Bankën Botërore. E rëndësishme është që ne të dimë efektivitetin e tyre, se si realizohet, se vërtet ngremë dorën, por çfarë ndodh nesër? Ne nuk e dimë se çfarë ndodh të nesërmen.

Këtu e kemi të keqen, të kontrolli i këtyre kredive që ne marrim, se janë kredi që, siç e kam thënë edhe herë tjetër, fëmijët tanë do t'i paguajnë, por ta dimë se kush është efektiviteti, çfarë realizojmë, si e realizojmë, me çfarë cilësie e realizojmë. Se është kollaj për të ngritur dorën për të dhënë **lekët**, por problemi është si menaxhohet më tej.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Beci në përgjigje të pyetjes së kolegut Fino.

Benet Beci – Ka një sistem përzgjedhjeje.

Meraku i zotit Fino është se si bëhet përzgjedhja e projekteve dhe si është kriteri.

Bashkim Fino – Jo, mor, nuk kam fare merak për atë unë!

Benet Beci – E kishit për kriteret, apo jo, për përzgjedhjen.

Bashkim Fino – Nuk kam fare shqetësim për kriteret dhe përzgjedhjen. Unë kam merakun që ato që bëhen, të bëhen me cilësi dhe të mos kthehen më mbrapsht.

Benet Beci – Absolutisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është pjesë e përgjegjësisë sonë të pjesa e realizimit, por edhe procesi i përzgjedhjes së saj është bërë me të gjitha bashkitë, me të gjitha...

Ky është një sistem absolutisht i certifikuar për mënyrën se si përzgjidhet.

Janë tri-katër rrugë kryesore që deri tani janë në *shortlist*-ën kryesore: është rruga Fier-Seman, rruga e Pogradecit, si dhe disa nga rrugët që janë ende në proces, që kanë dalë me impaktin më të lartë turistik, bujqësor dhe agrobujqësor, siç e tha zëvendësministri. Pra, janë tre-katër impakte që kanë bërë përzgjedhjen e tyre.

I gjithi është një proces që praktikisht është nën përgjegjësinë tonë të certifikimit dhe të zgjidhjeve teknike. Besoj se ne e realizojmë, pasi kemi një lloj eksperience për ta bërë këtë gjë ashtu siç pritet nga ju.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Beci!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Unë kam diskutim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jo, nëse do...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse nuk janë gati për votim, e ndërpresim mbledhjen që ta rifillojmë më vonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi edhe një pikë të gjashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Bashkim Fino - Meraku që kam unë, për këtë, nuk është në aspektin financiar. Ministria e Financave është e kujdesshme, kur merr kredi nga BB-ja. E rëndësishme është, që kur të vijmë këtu në parlament, të vijmë me çështje dhe me projekte konkrete, që të dimë se

çfarë do të bëjmë. Në fund të fundit, kur ngremë dorën për 45 milionët, të dimë se sa rrugë do të bëhen.

Këtu u tha vetëm se ishin 110 propozime nga bashkitë, por sa nga këto propozime do të realizohen dhe sa mund të mos realizohen? Në qoftë se do të ketë koordinim për këto 110 propozime, sepse mund të na ndodhë që nesër në praktikë, zoti kryetar, se ka ndodhur shpesh kjo dhe ju e dini shumë mirë që miratohen 110 projekte dhe në një moment të caktuar heqim 2-3 projekte dhe miratojmë një projekt, i cili na del si i ri. Kjo nuk është korrekte. Ne jemi deputetë të të gjitha qarqeve përkatëse. Nuk po luftojmë se cili qark merr më shumë dhe cili merr më pak. Nuk po hyj fare te kjo çështje, por nëse e kemi të detajuar një projekt të tillë, jemi të ndërgjegjshëm për atë që do të ngremë dorën.

Në qoftë se nuk e kemi të detajuar, por thjesht e kalojmë këtë kredi 45-milionëshe dhe pastaj më vonë bëhet përzgjedhja, jo sipas dëshirave të elektoratit, por edhe të deputetëve që janë këtu, kjo është e gabuar. Ky është thelbi i hezitimit që kam.

Kam edhe një fjalë, e cila dua të shënohet në procesverbal. Personalisht, unë nuk dua të përdorem, të votoj për një gjë dhe më pas në praktikë, të bëhet një investim tjetër. Kaq. Nëse e keni këtë mirë, nëse nuk e keni, ta sjellë zoti Benet se cilat janë projektet që do të realizohen me 45 milionë nesër apo pasnesër nuk ka rëndësi, që ne ta kemi dhe ta konkretizojmë.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Beci!

Benet Beci - Ka një keqkuptim. Kur them 110 propozime, do të thotë se janë marrë në shqyrtim si një listë e gjatë mbi të cilën ti punon për të bërë *short list-ën*, të cilën e bën sipas kriterëve. Është ajo që keni aty.

Bashkim Fino – Dakord. sa do të jetë? Sa do të jenë 4 projekte nga 110?

Benet Beci - Po.

Bashkim Fino – Pra, sot po miratojmë 4 rrugë?

Benet Beci - Jo, nuk mund ta themi.

Bashkim Fino – Si nuk mund ta themi?

Atëherë, çfarë themi ne?

Benet Beci - Jo, është fondi në dispozicion për rrugët.

Bashkim Fino – Po çfarë themi ne pastaj?

Benet Beci - Them se është ky fondi në dispozicion për të realizuar këto investime në rrugë. Ky është procesi i realizimit. Fati i madh i projektit, është që këto janë rrugë nacionale me një nivel më të lartë. Nuk janë më rrugë lokale.

Bashkim Fino – Kur negociohet për një kredi të caktuar, negociohet mbi bazën e projekteve të rrugëve që kemi. Nuk mund të negociohet në tërësi, sepse ne mund të kërkojmë

edhe 100 milionë dhe kemi mundësi të kërkojmë edhe kaq, por ne duhet të kalojmë në shqyrtim projektet konkrete. Në qoftë se ne kalojmë 50 dhe themi se janë 110 propozime nga të cilat vetëm 4 do të realizojmë, t'i dimë se kush janë ato të katërta, se ne nuk jemi kundër tyre. Ne do të jemi plotësisht dakord.

Alket Hyseni - Mund të jenë 4, mund të jenë 3, mund të jenë 5

Bashkim Fino – Po, këtë jam duke thënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni - FSHZH ka disa procedura strikte, të miratuara edhe nga institucionet partnere, të cilat ne nuk i ndërrojmë dot edhe po të duam, as ne, as fondi. Bazuar në ato procedura ai ndërton projektet e mundshme për t'u futur, të cilat mund të jenë 4, mund të jenë 3, mund të jenë 5 në varësi të mënyrës së tenderimit, ecurisë së projektit konkret, sepse nuk janë të detajuara. Prandaj mendoj se ka pak hapësira. Shqetësimi i zotit Fino është i drejtë.

Unë do të sugjeroja që te indikatorët në vijim, nëse e mundur zoti Beci, të futet edhe komunikimi me përfaqësues, përveç atyre të pushteti lokal edhe me deputetët, të cilët kanë zërin e tyre gjë që nuk është në indikatorët e sotëm, por unë mendoj se është një ndër institucionet më serioze teknike dhe besoj që për komisionin tonë është e mjaftueshme ta kapërcejmë sot dhe ta miratojmë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ne jemi komision për dhënie mendimi. Kjo nuk është marrëveshja e parë që vjen nga FSHZH-ja dhe as marrëveshja e fundit që kemi votuar për këtë fond. Shqetësimet e zotit Fino kanë qenë në dinamikë të përhershme, sa herë kemi kaluar marrëveshje të tilla me Fondin.

Problemi është ky ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Fino!

Askush nuk na pengon të ushtrojmë format e kontrollit parlamentar mbi marrëveshjet që ne miratojmë. Pra, komisioni ynë i ka të gjitha instrumentet e nevojshme. Janë 3 nënkomisione. Absolutisht, edhe unë jam dakord, t'i marrim të gjitha marrëveshjet e financimit që kemi votuar në komisionin tonë, por edhe në seancë plenare dhe të monitorojmë si kanë gjetur zbatim këto marrëveshje. Këtë duhet ta bëjmë jo vetëm me FSHZH-në, por edhe me të gjitha institucionet e tjera që sjellin marrëveshje në Kuvend. Kjo është detyra jonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Nuk po ju kuptoj, zoti kryetar. Po më tregoni se çfarë duhet të bëj unë? Kjo është çështje tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Unë nuk po të tregoj detyrën, por po flas për shqetësimin që ngritët ju. Nuk na pengon askush të kontrollojmë se si zbatohen fondet që miratojmë ne në Kuvend.

Bashkim Fino – Ndërhyrja juaj ishte thjesht, për ta kaluar dhe për ta votuar sa më shpejt. Fuqia jonë është te votimi. Në rast se ne bëhemi pengesë për t'i treguar se cilat janë projektet, hajde t'i kalojmë kështu, pavarësisht se jemi komision për dhënie mendimi. Pak rëndësi ka kjo. Njësoj është si për ne, si për Komisionin e Ekonomisë. Edhe në seancën plenare të parlamentit, njësoj është. Kjo është e rëndësishme, të kuptohet rëndësia e votimit që bëjmë ne, si parlament dhe ky autoritet që kemi si parlament, nuk mund të kalojë kështu duke thënë se kemi këto 110 propozime, kemi këto 3 rrugë dhe nesër mund të jenë edhe 3 edhe 5. Çfarë rëndësie ka? Unë dua të di se cilat janë dhe që duhet të bëhen. Kaq. Kjo më intereson.

Ulsi Manja – Ka diskutime të tjera? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

Kush është pro?

Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1.

Kush është pro? Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është pro? Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është pro? Kush është kundër? 1 votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, shpjegimin e votës do ta bëni në seancë plenare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 09.07.2018, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektvendim “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

(Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Nasip Naço, Silva Caka, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Enkelejd Alibeaj, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu.

Të Ftuar:

Robert Gajda - Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Gelardina Prodani - Sekretare e Përgjithshme, MFE

Mimoza Dhembli – Drejtore e Buxhetit në MFE

Vilma Çausholli - Përgjegjëse sektori.

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, në shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Bashkim Fino. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen, zoti Robert Gajda, Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi, zonja Gelardina Prodani, sekretare e Përgjithshme në MFE; zonja Mimoza Dhëmbi, drejtoreshë dhe zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse sektori.

Mirë se erdhët në komision, zoti Gajda!

Ju lutem, bëni një prezantim të shkurtër të strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës që ju keni kërkuar në Kuvend!

Robert Gajda – Nisur nga vjetërsia e ligjit të miratuar në vitin 2010 dhe strukturës së miratuar në vitin 2010, me dinamikat e reja në lidhje me shumë ligje të miratuara për të drejtat sociale, ku shumë nga këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, struktura aktuale është për 23 vende pune. Janë buxhetuar edhe 2 të tjerë, pra janë 25 dhe kërkohen edhe 9 të tjerë që të vejë numri në 34, duke pasur parasysh shumicën e kompetencave të shtuara dhe profilin kushtetues dhe territorial që kemi përfshirë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Fino!

Bashkim Fino – Nga pikëpamja e strukturës është bërë një paraqitje shumë dinjitoze nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Problemi qëndron te fakti që Ministria e Financave nuk i ka mundësitë për të financuar këtë shtesë prej 9 vetash, sepse edhe 2 të tjerë janë të buxhetuar. Ne kemi folur me sekretaren e përgjithshme të Ministrisë së Financave gjatë kësaj kohe se e kemi diskutuar edhe një herë këtë çështje. Kemi rënë dakord që në parim mund ta miratojmë strukturën. Natyrisht, nuk mund ta miratojmë menjëherë këtë numër që kërkon Komisioneri, por në kuadër të përgatitjes së buxhetit në muajt tetor-nëntor të vitit të ardhshëm, janë të gjitha mundësitë për ta riparë numrin e përgjithshëm të nëpunësve në Shqipëri. Kështu, unë mendoj ta miratojmë në parim këtë numër dhe më pas Ministria e Financave të shikojë mundësinë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Prodani, jeni dakord me mendimin e zotit Fino?

Gelardina Prodani – Dakord.

Për arsye të kushtit që kemi tani me nenin 11 të ligjit për buxhetin e vitit 2018, nuk mund të marrim angazhime, të cilat kanë kosto financiare. Kjo është arsyeja që Ministria e Financave u shpreh e kufizuar në shkresën e saj.

Nga ana tjetër, në parim shprehemi dakord, por kjo do të rivlerësohet gjatë shqyrtimit të projektbuxhetit për vitin 2019.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Prodani!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Falënderoj relatorin Fino!

Nga ana tjetër, do të doja të sillja në vëmendje të Ministrisë së Financave se Shqipëria ka një detyrim lidhur me të gjitha institucionet e pavarura, por në mënyrë të veçantë me Avokatin e Popullit dhe me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ne duhet të rishikojmë buxhetet, burimet njerëzore dhe financiare, sepse ato janë dy institucione të rëndësishme dhe Shqipëria në vitin 2019 do të jetë në monitorim për të parë se si Kuvendi i Shqipërisë do t'i ketë përmbushur detyrimet e pavarësisë financiare dhe rritjen e burimeve njerëzore të këtyre dy institucioneve.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Atëherë, kalojmë në votimin të projektvendimit “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektvendimi.

Me këtë pikë të fundit të rendit të ditës e mbyllim mbledhjen e komisionit. Mbledhja e radhës së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

